



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-07

Prokurori k. Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Vendos: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 24 dhjetor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim për rishikimin e paraburgimit të Hysni Gucatit

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të Hysni Gucatit

Xhonatan Elistan Ris

Mbrojtësit të Nasim Haradinajt

Tobi Kadman

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në përputhje me nenin 41(10) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 57(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), nxjerr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 22 shtator 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) kërkoi arrestimin e Hysni Gucati (“z. Gucati”) dhe Nasim Haradinajt (“z. Haradinaj”) për shpërndarjen e pretenduar të informacionit konfidencial lidhur me punën e Task Forcës Hetimore Speciale (“TFHS”) dhe/ose të ZPS-së në tri konferenca për shtyp të mbajtura më 7, 16 dhe 22 shtator 2020 (të quajtura, përkatësisht, “konferenca e parë për shtyp”, “konferenca e dytë për shtyp” dhe “konferenca e tretë për shtyp”) dhe kërkoi transferimin e tyre në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara (“DHS”).²

2. Më 24 shtator 2020, Gjykatësi i Vetëm lëshoi fletarrestimet për z. Gucati dhe z. Haradinaj për tentim të frikësimit të dëshmitarëve, hakmarrje dhe shkelje të fshehtësisë së procedurës, dhe urdhëroi transferimin e tyre në objektin e paraburgimit të DHS-së (“Vendimi për arrestim dhe transferim”).³

¹ KSC-BC-2020-07, F00061, Kryetarja, *Vendim për caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 29 tetor 2020, publik. Para këtij vendimi, Kryetarja e kishte caktuar të njëjtin gjykatës si Gjykatës të Vetëm; *shih* KSC-BC-2020-07, F00003, Kryetarja, *Vendim për caktimin e Gjykatësit të Vetëm sipas nenit 33(2) të Ligjit*, 29 maj 2018, publik

² KSC-BC-2020-07, F00009/RED, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë urgjente për fletarrestime dhe për urdhra në lidhje me to, parashtrimi KSC-BC-2020-07/F0009 i datës 22 shtator 2020*, 22 shtator 2020, publik, para. 1, 35(a), me shtojcat 1-2, publik.

³ KSC-BC-2020-07, F00012, Gjykatësi i Vetëm, *Vendim mbi kërkesën për fletarrestime dhe urdhra transferimi (“Vendimi për arrestim dhe transferim”)*, 24 shtator 2020, publik, para. 36, me shtojcat 1-4, publike.

3. Më 25 shtator 2020, z. Gucati u arrestua⁴ dhe u transferua në objektin e paraburgimit të DHS-së në Hagë, Holandë.⁵
4. Më 29 shtator 2020, z. Gucati paraqiti “Kërkesën për dorëzani”.⁶ Më 27 tetor 2020, Gjykatësi i Vetëm e hodhi poshtë këtë kërkesë (“Vendimi i parë për paraburgimin”).⁷
5. Më 30 tetor 2020, ZPS-ja paraqiti për konfirmim aktakuzën rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* (“Aktakuza”) kundër z. Gucati dhe z. Haradinaj, së bashku me materialin provuese në mbështetje të fakteve mbi të cilat bazohen akuzat si dhe një përmbledhje të detajuar në të cilën tregohet lidhja e secilës provë me secilën akuzë.⁸
6. Më 9 dhjetor 2020, paneli i Gjykatës së Apelit nxori vendim në të cilin ndër të tjera hodhi poshtë apelin e z. Gucati të vendimit të parë për paraburgimin.⁹ Më të njëjtën ditë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake kërkoi nga palët që deri më 18 dhjetor 2020 të dorëzonin parashtrime me shkrim lidhur me vazhdimin e paraburgimit të z. Gucati.¹⁰
7. Më 11 dhjetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e konfirmoi pjesërisht aktakuzën dhe urdhëroi ZPS-në që të paraqiste aktakuzën e rishikuar, të konfirmuar (“Aktakuza e Konfirmuar”).¹¹

⁴ KSC-BC-2020-07, F00012/A01/RED, Gjykatësi i Vetëm, *Versioni i redaktuar publik i fletarrestimit për Hysni Gucatin* (“Fletarrestimi”), 24 shtator 2020, publik; F00015, Administratorja, *Njoftimi i arrestimit sipas rregullës 55(4)*, 25 shtator 2020, publik.

⁵ KSC-BC-2020-07, F00012/A02/RED, Gjykatësi i Vetëm, *Versioni i redaktuar publik i urdhrit për transferim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 24 shtator 2020, publik; F00018, Administratorja, *Njoftim i pranimit të Hysni Gucati në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 25 shtator 2020, publik, me shtojcën 1, konfidenciale.

⁶ KSC-BC-2020-07, F00038, Mbrojtja, *Kërkesë për dorëzani*, 29 shtator 2020, publike.

⁷ KSC-BC-2020-07, F00059, Gjykatësi i Vetëm, *Vendim mbi kërkesën për dorëzani* (“Vendimi i parë për paraburgimin”), 27 tetor 2020, publik.

⁸ KSC-BC-2020-07, F00063, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës për konfirmim dhe kërkesave në lidhje me të*, 30 tetor 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, me shtojcat 1 dhe 2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁹ KSC-BC-2020-07/IA001, F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi apelin e Hysni Gucati për çështje të lidhura me arrestimin dhe mbajtjen e tij në paraburgim* (“Vendimi mbi apelin e vendimit të parë për paraburgimin”), 9 dhjetor 2020, publik, para. 78.

¹⁰ KSC-BC-2020-07, F00073, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për parashtrime në lidhje me rishikimin e paraburgimit*, 9 dhjetor 2020, publik.

¹¹ KSC-BC-2020-07, F00074/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Versioni i redaktuar publik i vendimit për konfirmimin e aktakuzës* (“Vendimi i konfirmimit”), 11 dhjetor 2020, publik.

8. Më 14 dhjetor 2020, ZPS-ja paraqiti Aktakuzën e Konfirmuar,¹² me redaktime të autorizuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.¹³ Në Aktakuzën e Konfirmuar, z. Gucati dhe z. Haradinaj akuzohen për kryerjen e veprave penale sipas neneve 387, 388, 392 dhe 401 të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019 (“KPK”), në bazë të nenit 15(2) të Ligjit.¹⁴

9. Më 17 dhjetor 2020, z. Gucati paraqiti “Parashtrime në lidhje me rishikimin e paraburgimit deri më 27 dhjetor 2020”.¹⁵

10. Më 18 dhjetor 2020, ZPS-ja dorëzoi “Parashtrime përmbledhëse të Prokurorisë në lidhje me rishikimin e paraburgimit”.¹⁶

II. PARASHTRIMET

11. Z. Gucati parashton se paraburgimi i tij duhet të ndërpritet dhe ai të lirohet me ose pa kushte.¹⁷ Z. Gucati e kundërshton ekzistencën e rreziqeve në lidhje me pengimin e procesit apo kryerjen e krimeve të tjera.¹⁸ Si alternativë, z. Gucati parashton se, përveç kushteve që janë propozuar deri më tani (“kushtet e propozuara”),¹⁹ rreziku se ai mund të pengojë ecurinë e procesit dhe/ose kryejë krime të tjera mund të parandalohet me kushtet shtesë në vijim: (i) ndalimi për të hyrë në Prishtinë; (ii) përdorimi i një pajisjeje të vetme elektronike për komunikim, të dhënat

¹² KSC-BC-2020-07, F00075, Prokurori i Specializuar, *Parashtrimi i aktakuzës së konfirmuar*, 14 dhjetor 2020, publik, me shtojcën 1 (“Aktakuza e konfirmuar”), rreptësisht konfidenciale, dhe shtojca 2 (“Aktakuza e konfirmuar e redaktuar publike”), publike.

¹³ Vendimi i konfirmimit, para. 155(c).

¹⁴ Aktakuza e konfirmuar e redaktuar publike, para. 48.

¹⁵ KSC-BC-2020-07, F00087/RED, Mbrojtja, *Parashtrime në lidhje me rishikimin e paraburgimit deri më 27 dhjetor* (“Parashtrimi i Mbrojtjes”), 17 dhjetor 2020, publik.

¹⁶ KSC-BC-2020-07, F00088, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime përmbledhëse të Prokurorisë në lidhje me rishikimin e paraburgimit* (“Parashtrimi i ZPS-së”), 18 dhjetor 2020, publik.

¹⁷ Parashtrimi i Mbrojtjes, para. 2, 30.

¹⁸ Parashtrimi i Mbrojtjes, para. 16-26.

¹⁹ Parashtrimi i Mbrojtjes, para. 27; Kushtet e propozuara më parë përfshinin dorëzaninë prej 5000 euro, dorëzimin e pasaportës, qëndrimin dhe fjetjen në shtëpi, raportimin ditor në zyrat e policisë së Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, kufizimin e kontakteve dhe ndalimin e vizitave në zyrat e Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, shih Vendimin e parë për paraburgimin, para. 6.

e së cilës do t'i jepen ZPS-së; dhe/ose (iii) qëndrimi jashtë Kosovës ("kushtet shtesë").²⁰
Z. Gucati gjithashtu kërkon seancë gojore për të plotësuar parashtrimet me shkrim dhe për t'iu përgjigjur parashtrimeve të ZPS-së.²¹

12. ZPS-ja parashtron se vazhdimi i paraburgimit është i domosdoshëm meqenëse nuk ka ndryshim të rrethanave që i zhvlerësojnë arsyet e përcaktuara për paraburgim.²² ZPS-ja gjithashtu parashtron se rreziqet e nenit 41(6)(b) janë shtuar që nga vendimi i fundit për paraburgim.²³ ZPS-ja vë në dukje faktin se tani ekziston konstatimi shtesë i dyshimit të bazuar se z. Gucati ka kryer veprën penale të pengimit të personave zyrtarë në ushtrimin e detyrave zyrtare sipas nenit 401 të KPK-së.²⁴ ZPS-ja gjithashtu parashtron se Aktakuza e Konfirmuar pretendon vepra që shkojnë përtej atyre të përmendura në fletarrestim dhe në vendimin e parë për paraburgim, duke qartësuar kështu natyrën e rëndë të akuzave dhe duke e bërë edhe më konkrete mundësinë e dënimit.²⁵ ZPS-ja pretendon se këto rreziqe në rritje mund të trajtohen në mënyrë të efektshme vetëm nga objekti i paraburgimit të DHS-së.²⁶

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

13. Neni 41(6) i Ligjit përcakton se DHS-ja urdhëron arrestimin dhe paraburgimin e një personi vetëm kur ekziston dyshimi i bazuar se ai ka kryer vepër penale që është nën juridiksionin e DHS-së; dhe ekzistojnë arsye të artikulueshme të besohet se (i) ekziston rreziku i arratisjes; (ii) personi do të shkatërrojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë prova ose kur rrethana të caktuara tregojnë se personi do ta pengojë ecurinë e procedimit penal; ose (iii) do ta përsërisë veprën penale, do të përfundojë një vepër penale të tentuar, ose do të kryejë një vepër penale që ka kërcënuar se do ta kryejë.

²⁰ Parashtrimi i Mbrojtjes, para. 27-29.

²¹ Parashtrimi i Mbrojtjes, para. 31-34.

²² Parashtrimi i ZPS-së, para. 1.

²³ Parashtrimi i ZPS-së, para. 1.

²⁴ Parashtrimi i ZPS-së, para. 3.

²⁵ Parashtrimi i ZPS-së, para. 4.

²⁶ Parashtrimi i ZPS-së, para. 4-5.

14. Neni 41(10) i Ligjit përcakton se, deri në momentin kur aktgjykimi të jetë i formës së prerë ose deri në lirim, pas kalimit të dy (2) muajve nga vendimi i fundit për mbajtje në paraburgim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ose paneli i ngarkuar me këtë çështje shqyrton se a ekzistojnë ende arsyet për mbajtje në paraburgim dhe jep vendimin për vazhdimin ose përfundimin e paraburgimit.

15. Neni 41(12) i Ligjit përcakton se, përveç paraburgimit, mund të urdhërohen masat në vijim për të siguruar praninë e të akuzuarit, për të parandaluar përsëritjen e krimeve ose për të siguruar zhvillim të suksesshëm të procedimit penal: fletëthirrja, fletarrestimi, dorëzania, arresti shtëpiak, premtimi për të mos u larguar nga vendbanimi, ndalimi për t'iu afruar vendeve apo personave të caktuar, paraqitja në stacion të policisë apo në një vend tjetër, dhe masa alternative shmangëse.

16. Në përputhje me rregullën 57(2) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e rishikon vendimin për paraburgim pas kalimit të dy (2) muajve nga vendimi i fundit për paraburgim.

IV. DISKUTIM

17. Neni 41(10) i Ligjit e obligon Gjykatësin e Procedurës Paraprake që të shqyrtojë nëse ekzistojnë ende arsyet për paraburgim, përfshirë arsyet e përcaktuara në nenin 41(6), konkretisht, (i) a ekziston dyshim i bazuar se personi ka kryer krime dhe (ii) a ka arsye të artikulueshme për të besuar se është plotësuar ndonjëri nga kriteret e përcaktuara në nenin 41(6)(b) të Ligjit. Vendimi në vijim i trajton kriteret e nenit 41 (6) të Ligjit brenda kornizës së parashtrimeve nga palët.

A. DYSHIMI I BAZUAR

18. Sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të vitit 2012, Ligji Nr. 04/L-123, standardi provues i “dyshimit të bazuar” përkufizohet si “njohuri për informacionin që do të bindte një vëzhgues objektiv që një vepër penale ka ndodhur, po ndodh ose

ka mundësi të konsiderueshme që do të ndodhë dhe se personi në fjalë ka më shumë gjasa që të ketë kryer veprën penale se sa që të mos e ketë kryer atë.”.²⁷

19. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje, që në fillim, parashtrimin e z. Gucati se ai nuk është në gjendje që të vlerësojë peshën e provave në mbështetje të Aktakuzës së Konfirmuar sepse ky material nuk është nxjerrë ende dhe Aktakuza e Konfirmuar nuk përbën në vetvete bazë për një vlerësim të tillë.²⁸

20. Siç është theksuar nga z. Gucati, nuk është vlerësuar pesha e materialit mbështetës. Sidoqoftë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se procesi i vlerësimit të provave që mbështesin pretendimet e ZPS-së të pasqyruara në Aktakuzën e Konfirmuar, fillon me nxjerrjen e provave në përputhje me rregullën 102(1)(a) të Rregullores dhe do të vazhdojë gjatë fazës së gjykimit të procesit, kur përcaktohet fajësia ose pafajësia e z. Gucati në lidhje me akuzat. Për të përcaktuar nëse paraburgimi është i përshtatshëm, mjafton që, në këtë fazë të procesit, z. Gucati të marrë materialin që është paraqitur në mbështetje të fletarrestimit.

21. Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se, kur e ka konfirmuar Aktakuzën, ka konstatuar se ekziston dyshimi i bazuar mirë se z. Gucati ka kryer vepra penale brenda juridiksionit të DHS-së, konkretisht: (i) pengim të personave zyrtarë në ushtrimin e detyrave zyrtare përmes kërcënimeve të rënda; (ii) pengim të personave zyrtarë në ushtrimin e detyrave zyrtare me anë të veprimeve të përbashkëta si grup; (iii) frikësim gjatë procedimit penal; (iv) hakmarrje; (v) shkelje të fshehtësisë së procedurës përmes zbulimit të paautorizuar të informacionit të mbrojtur; dhe (vi) shkelje të fshehtësisë së procedurës përmes zbulimit të paautorizuar të identitetit

²⁷ Vendimi për arrestim dhe transferim, para. 18. *Shih gjithashtu* nenin 5(1)(c) të Konventës (Evropiane) për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, interpretuar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, *Fox, Campbell and Hartley v. United Kingdom*, no. 12244/86; 12245/86; 12383/86, Judgment, 30 August 1990, vol. 182, Series A, p. 16, para. 32; *K.-F. v. Germany*, no. 144/1996/765/962, Judgment, 27 November 1997, Reports 1997-VII, para. 57; *Labita v. Italy*, no. 26772/95, Judgment, 6 April 2000, para. 155; *Berkday v. Turkey*, no. 22493/93, Judgment, 1 March 2001, para. 199; *O’Hara v. United Kingdom*, no. 37555/97, Judgment, 16 O 2001, para. 34.

²⁸ Parashtrimi i Mbrojtjes, para. 3-6.

dhe/ose të dhënave personale të personave të mbrojtur në kundërshtim me nenet 387, 388, 392 dhe 401 të KPK, në bazë të nenit 15(2) të Ligjit.²⁹

22. Sa i përket pretendimit të z. Gucati se faktikisht nuk janë bërë kërcënime dhe as nuk është shkaktuar ndonjë dëm apo përdorur forca,³⁰ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se këto argumente janë ngritur dhe janë hedhur poshtë në vendimin e parë për paraburgim³¹ dhe, do të shqyrtohen më poshtë vetëm për atë sa këto argumente kanë të bëjnë me shqyrtimin e rreziqeve të nenit 41(6)(b).

23. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se përmbushet standardi i nenit 41(6)(a) të Ligjit.

B. DOMOSDOSHMERIA E PARABURGIMIT

24. Kur përmbushet standardi i nenit 41(6)(a) të Ligjit, arsyet që e lejojnë Gjykatësin e Procedurës Paraprake që t'i heqë lirinë një personi, duhet të jenë të artikulueshme.³² Në këtë aspekt, kujtojmë se përcaktimi i ekzistencës së cilitdo rrezik sipas nenit 41(6)(b)(i)-(iii) të Ligjit, për arsyetimin e domosdoshmërisë së paraburgimit të personit, ka të bëjë me vlerësimin e mundësisë së materializimit të rreziqeve të tilla, e jo të pashmangshmërisë.³³

²⁹ Vendimi i konfirmimit, para. 103, 109, 113, 117, 121, 125.

³⁰ Parashtrimi i Mbrojtjes, para. 24;

³¹ Vendimi i parë për paraburgimin, para. 24.

³² Neni 19.1.9 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

³³ Vendimi mbi apelin e vendimit të parë për paraburgimin, para. 67. Vendimi për arrestim dhe transferim, para 19. Ngjashëm, ICC, *Prosecutor v. Bemba Gombo et al.*, ICC-01/05-01/13-558, Appeals Chamber, [Judgment on the appeal of Mr Aimé Kilolo Musamba against the decision of Pre-Trial Chamber II of 14 March 2014 entitled "Decision on the 'Demande de mise en liberté provisoire de Maître Aimé Kilolo Musamba'"](#), 11 July 2014, para. 107.

1. Rreziku i arratisjes

25. Sa i përket rrezikut të arratisjes, z. Gucati thekson se: (i) ka qenë bashkëpunues gjatë arrestimit, transferimit dhe paraburgimit; (ii) ka lidhje të forta familjare dhe në komunitet në qytetin ku banon; dhe (iii) ka përgjegjësi ndaj nënës së tij plakë dhe të sëmurë.³⁴ ZPS-ja pretendon se rreziku ekzistues i arratisjes është rritur që nga vendimi i parë për paraburgim dhe do të vazhdojë të rritet me vijimin e mëtejshëm të procesit.³⁵

26. Ndonëse ka konstatuar më herët se kushtet e propozuara mund të adresojnë rrezikun e arratisjes, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se është e domosdoshme që ta rishqyrtojë këtë rrezik në rrethanat aktuale të z. Gucati. Në këtë aspekt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se, që nga vendimi i parë për paraburgimin, ZPS-ja ka dorëzuar Aktakuzën e Konfirmuar. Ky faktor e mbështet vlerësimin e mëhershëm të Gjykatësit të Procedurës Paraprake se ekziston rreziku që z. Gucati të arratiset. Ky rrezik do të shqyrtohet në lidhje me kushtet e propozuara në pjesën C më poshtë.

27. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se rreziku që z. Gucati të arratiset ekziston ende.

2. Pengimi i ecurisë së procedimit penal

28. Sa i përket rrezikut që z. Gucati të pengojë procedimin penal duke shpërndarë informacionin konfidencial dhe jopublik, z. Gucati deklaron se: (i) nuk ka përmendur emrin e asnjë individi dhe nuk ka bërë publike asnjë dosje,³⁶ përveç emrave të dy zyrtarëve publikë;³⁷ (ii) nuk është e qartë se deri në çfarë mase ky informacion nuk ka qenë tashmë publik;³⁸ (iii) nuk ka pasur shkelje të urdhrit të Gjykatësit të Vetëm;³⁹ dhe

³⁴ *Shih* Parashtrimi i Mbrojtjes, para. 25-26.

³⁵ Parashtrimi i ZPS-së, para. 3-4.

³⁶ Parashtrimi i Mbrojtjes, para. 17, 19, 21.

³⁷ Parashtrimi i Mbrojtjes, para. 23.

³⁸ Parashtrimi i Mbrojtjes, para. 23.

³⁹ Parashtrimi i Mbrojtjes, para. 18, 20, 22.

(iv) nuk ka sugjerime se veprimet e z. Gucati kanë rezultuar faktikisht në përdorimin e forcës, kërcënime ose në dëme.⁴⁰ ZPS-ja pretendon se rreziku ekzistues i pengimit është rritur që nga vendimi i parë për paraburgimin dhe do të vazhdojë të rritet me vijimin e mëtejshëm të procesit.⁴¹

29. Fillimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton konstatimin e tij se z. Gucati ka marrë pjesë në shpërndarjen e informacionit konfidencial dhe jopublik.⁴²

30. Sa u përket emrave të individëve, në konferencën e parë për shtyp, z. Gucati ia dha fjalën zëvendësit të tij, z. Haradinaj, i cili, në prani të z. Gucati, përmendi emrat dhe të dhënat personale të dëshmitarëve të mundshëm.⁴³ Në konferencën e dytë për shtyp, z. Gucati përmendi emrat e dy personave të cilit kishin bashkëpunuar me TFHS-në.⁴⁴ Në konferencën e tretë për shtyp, lidhur me emra të individëve, z. Gucati pranoi shprehimisht se nuk ishte i autorizuar të zbulonte asnjë emër.⁴⁵ Në vijim, z. Gucati ia dha fjalën zëvendësit të tij, z. Haradinaj, i cili, në praninë e tij, përmendi emrat e të akuzuarve të mundshëm, emrin e një dëshmitari të mundshëm dhe emrat e personave dhe vendeve të tjera nga dokumentet përkatëse.⁴⁶ Në parashtrimet e tij, z. Gucati i shtrembëron faktet. Ai ka zbuluar emrat e individëve bashkëpunimi i të cilëve me TFHS-në dhe/ose me ZPS-në, pa marrë parasysh nëse kanë mbajtur funksione publike ose jo, konsiderohej informacion konfidencial dhe jopublik.⁴⁷

31. Sa i përket publikimit të informacionit konfidencial dhe jopublik, z. Gucati i inkurajoi mediat që të botonin informacion konfidencial duke thënë “e keni materialin para jush, ashtu siç i bëtë publike emrat e veteranëve të rrejtshëm, merreni të njëjtin

⁴⁰ Parashtrimi i Mbrojtjes, para. 24.

⁴¹ Parashtrimi i ZPS-së, para. 4.

⁴² Vendimi për arrestim dhe transferim, para. 29.

⁴³ KSC-BC-2020-07, F0009/RED/A01, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 1 e Kërkesës për fletarrestime dhe urdhra të lidhura me to* (“Shtojca 1 e kërkesës për fletarrestime”), 1 tetor 2020, publike, f. 3-4, 6.

⁴⁴ Shtojca 1 e Kërkesës për fletarrestime, f. 8, 11.

⁴⁵ Shtojca 1 e Kërkesës për fletarrestime, f. 13-14.

⁴⁶ Shtojca 1 e Kërkesës për fletarrestime, f. 14-15.

⁴⁷ KSC-BC-2020-07, F00005, Gjykatësi i Vetëm, *Vendim urgjent që autorizon sekuestrim* (“Urdhri i parë”), 7 shtator 2020, publik, para. 11-13. KSC-BC-2020-07, F00007, Gjykatësi i Vetëm, *Vendim që autorizon sekuestrim* (“Urdhri i dytë”), 17 shtator 2020, publik, para. 11-13.

guxim”.⁴⁸ Z. Gucati ishte gjithashtu i pranishëm kur zëvendësi i tij, z. Haradinaj, tha se Organizata e Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (“OVL-UÇK”) do të shpërndante informacionin konfidencial ose jopublik⁴⁹ ose kur tha se këto dokumente ishin në dispozicion për t’u marrë.⁵⁰

32. Sa u përket paqartësive në lidhje me konfidencialitetin e informacionit në fjalë, z. Gucati pranoi në atë kohë se informacioni që ai dhe z. Haradinaj po nxirrnin, ishte konfidencial dhe jopublik, dhe se nuk ishte i autorizuar për një nxjerrje të tillë.⁵¹ Për më tepër, urdhrat e Gjykatës të Vetëm, të cilat i ishin dërguar dhe/ose dorëzuar⁵² z. Gucati dhe OVL-UÇK-së, e konfirmonin qartë natyrën konfidenciale dhe jopublike të informacionit në fjalë.⁵³

33. Sa i përket shkeljes së urdhrave të Gjykatës të Vetëm, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se shpërndarja e informacionit konfidencial dhe jopublik vazhdoi edhe pasi z. Gucati u urdhërua në dy raste që të mos e bënte këtë.⁵⁴ Në fakt, pas lëshimit të këtyre urdhrave, z. Gucati deklaroi publikisht se ai dhe OVL-UÇK-ja do të vazhdonin të bënin publike të gjitha dokumentet që do të merrnin⁵⁵ dhe inkurajoi pjesëtarët e mediave që të bënin të njëjtën gjë.⁵⁶ Në kundërshtim me pretendimet e z. Gucati, urdhrat e Gjykatës të Vetëm nuk kishin të bënin vetëm me sekuestrimin e dokumenteve të caktuara, por gjithashtu konfirmonin natyrën e ndjeshme të

⁴⁸ Shtojca 1 e Kërkesës për fletarrestime, f. 24.

⁴⁹ Shtojca 1 e Kërkesës për fletarrestime, f. 2, 4-6.

⁵⁰ Shtojca 1 e Kërkesës për fletarrestime, f. 10.

⁵¹ Shtojca 1 e Kërkesës për fletarrestime, f. 13-14. *Shih gjithashtu* Shtojca 1 e Kërkesës për fletarrestime, faqet 5, 10.

⁵² KSC-BC-2020-07, F00008, Prokurori i Specializuar, *Raport i Prokurorisë në pajtim me vendimin KSC-BC-2018-01/F00121*, 21 shtator 2020, konfidencial, me shtojcën 1, konfidenciale; KSC-BC-2020-07, F00028, Prokurori i Specializuar, *Raport i Prokurorisë në pajtim me vendimin KSC-BC-2018-01-F00123*, 29 shtator 2020, konfidencial, para. 2, 5, me shtojcën 1, konfidenciale.

⁵³ Urdhri i parë, para. 11-13, 21-22; Urdhri i dytë, para. 11-13, 21-22.

⁵⁴ Urdhri i parë, para. 22; Urdhri i dytë, para. 22.

⁵⁵ Shtojca 1 e Kërkesës për fletarrestime, f. 14.

⁵⁶ Shtojca 1 e Kërkesës për fletarrestime, f. 24.

informacionit nga hetimet e TFHS/ZPS-së dhe paralajmëronin që këto dokumente, dhe/ose përmbajtja e tyre, të mos shpërndareshin.⁵⁷

34. Për më tepër, sa i përket pretendimit se faktikisht nuk ka pasur përdorim të forcës, kërcënime apo dëme, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se, në konferencën e parë për shtyp, z. Haradinaj, në praninë e z. Gucati, pranoi dëmin dhe rrezikun që paraqet për dëshmitarët e mundshëm shpërndarja e informacionit konfidencial dhe jopublik.⁵⁸ Më konkretisht, z. Haradinaj shtroi pyetjen, në praninë e z. Gucati, “si mund të garantohet siguria e dëshmitarëve kur emrat e tyre mund të lexohen nga çdokush” dhe deklaroi me tej se nuk “bregoset për dëshmitarët e gjykatës së Hagës” dhe “do të publikoja të dhënat e të gjithë dëshmitarëve të kësaj gjykate”.⁵⁹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se ato pyetje, të shtruara në konferencë për shtyp, përbëjnë kërcënime të tërthorta për sigurinë e dëshmitarëve të mundshëm.

35. Gjykatësi i Procedurës Paraprake i referohet konstatimit të tij se, nëse lirohet, z. Gucati do të ishte në gjendje të merrte, pa mbikëqyrje, informacion konfidencial dhe jopublik.⁶⁰ Si kryesues i OVL-UÇK-së, z. Gucati do të kishte gjithashtu edhe mjete e mënyra për ta shpërndarë këtë informacion duke komunikuar lirisht me media ose me rrjetin e veteranëve të UÇK-së, ose duke e botuar materialin vetë.⁶¹ Çfarëdo garanci personale për moskryerjen e veprimeve të tilla nuk mund të besohet duke pasur parasysh deklaratat e tij publike se do të vazhdojë të nxjerrë informacion konfidencial dhe jopublik⁶² dhe mosrespektimin prej tij të urdhrave të Gjykatësit të Vetëm.⁶³

36. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ende ekziston rreziku që z. Gucati mund të pengojë zhvillimin e procesit.

⁵⁷ Urdhri i parë, para. 21, 22, 25; Urdhri i dytë, para. 21, 22, 25.

⁵⁸ Shtojca 1 e Kërkesës për fletarrestime, f. 5-6.

⁵⁹ Shtojca 1 e Kërkesës për fletarrestime, f. 6.

⁶⁰ Vendimi i parë për paraburgimin, para. 17.

⁶¹ Vendimi i parë për paraburgimin, para. 17.

⁶² Vendimi i parë për paraburgimin, para. 17; Shtojca 1 e Kërkesës për fletarrestime, f. 13.

⁶³ Vendimi i parë për paraburgimin, para. 17; Urdhri i parë, para. 11-13, 21-22; Urdhri i dytë, para. 11-13, 21-22.

3. Rreziku i kryerjes së veprave penale të tjera

37. Sa i përket rrezikut që z. Gucati mund të kryejë vepra penale të tjera, për arsytet e diskutuara më lart lidhur me pengimin e procesit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ende ekziston rreziku që z. Gucati mund të kryejë vepra penale të tjera duke kërcënuar, frikësuar ose rrezikuar dëshmitarë (të mundshëm) përmes nxjerrjes ose shpërndarjes të informacionit.

4. Përfundim

38. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ende ekziston rreziku që z. Gucati të arratiset, të pengojë ecurinë e procesit ose të kryejë vepra penale të tjera. Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të vlerësojë më poshtë nëse rreziqet mund të adresohen në mënyrë të përshtatshme me kushtet e propozuara dhe/ose kushtet shtesë.

C. LIRIMI ME KUSHT

39. Z. Gucati parashtron se rreziku që ai mund të pengojë ecurinë e procesit dhe/ose të kryejë krime të tjera mund të parandalohet në mënyrë të përshtatshme me kushtet e propozuara, të zgjeruara me kushtet shtesë.⁶⁴ Z. Gucati pretendon se qëndrimi jashtë Kosovës dhe kufizimi i mundësive për të komunikuar në mënyrë elektronike do të bënin që ai nuk do të ishte në gjendje të merrte ose shpërndante informacion konfidencial ose jopublik dhe do të parandalonte çdo kontakt të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me dëshmitarë.⁶⁵

40. Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton se, sa i përket rrezikut të arratisjes, është konstatuar se lidhjet e ngushta familjare dhe me komunitetin të z. Gucati në qytetin e banimit ishin faktor lehtësues dhe se kushtet e propozuara mund ta adresojnë

⁶⁴ Parashtrimi i Mbrojtjes, para. 15, 27-30.

⁶⁵ Parashtrimi i Mbrojtjes, para. 28.

rrezikun në mënyrë të përshtatshme.⁶⁶ Sa u përket parashtrimeve aktuale të z. Gucati, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje në mënyrë të favorshme faktorët lehtësues shtesë në vijim: (i) bashkëpunimi i z. Gucati gjatë arrestimit, transferimit dhe paraburgimit⁶⁷ dhe (ii) përgjegjësitë që ka ndaj nënës plakë dhe të sëmurë.⁶⁸

41. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se rreziku i arratisjes vazhdon të adresohet në mënyrë të përshtatshme me kushtet e propozuara.

42. Sa i përket rrezikut të pengimit të ecurisë së procesit ose kryerjes së veprave penale të tjera, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se qëndrimi jashtë Kosovës nuk e adreson si duhet rrezikun që z. Gucati mund ta pengojë ecurinë e procesit. Z. Gucati mund të marrë në mënyrë elektronike, ose përmes postës, informacion konfidencial ose jopublik dhe mund ta shpërndajë këtë informacion në mënyrë të njëjtë, qoftë në Kosovë apo jashtë saj. Për më tepër, përdorimi i një pajisjeje elektronike të vetme nuk mund të monitorohet ose të zbatohet, edhe nëse të dhënat e një pajisjeje të tillë i jepen ZPS-së.

43. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se rreziqet e arratisjes, pengimit të procesit ose kryerjes së veprave penale të tjera mund të trajtohen në mënyrë efektive vetëm nga paraburgimi. Kjo është veçanërisht e vërtetë duke pasur parasysh deklaratat publike të z. Gucati se do të nxjerrë informacion konfidencial dhe jopublik⁶⁹ dhe mosrespektimin prej tij të urdhrave të Gjykatësit të Vetëm.⁷⁰ Në këto rrethana, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se lirimi me kusht do të ishte i pamjaftueshëm për të tejkaluar rreziqet sipas nenit 41(6)(b) të identifikuar më lart.

⁶⁶ Vendimi i parë për paraburgimin, para. 14-15.

⁶⁷ KSC-BC-2020-07, F00031/RED, Administratorja, *Versioni i redaktuar publik i 'Raportit mbi arrestimin dhe transferimin e Hysni Gucatit në objektin e paraburgimit', parashtrimi KSC-BC-2020-07/F00031 i datës 30 shtator 2020, 14 tetor 2020, publik, para. 8.*

⁶⁸ Parashtrimi i Mbrojtjes, para. 26. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se z. Gucati nuk kërkon lirim të përkohshëm në bazë të arsyeve humanitare bindëse në përputhje me rregullën 56(3) të Rregullores.

⁶⁹ Vendimi i parë për paraburgimin, para. 17; Shtojca 1 e Kërkesës për fletarrestime, f. 13.

⁷⁰ Vendimi i parë për paraburgimin, para. 17; Urdhri i parë, para. 11-13, 21-22; Urdhri i dytë, para. 11-13, 21-22.

44. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se kushtet e propozuara dhe kushtet shtesë nuk i zbusin në masë të mjaftueshme rreziqet e pengimit të ecurisë së procesit, ose të kryerjes së veprave penale të tjera.

D. PROPORCIONALITETI I PARABURGIMIT

45. Z. Gucati parashtron se sa më gjatë që personi mbahet në paraburgim aq më e madhe barra mbi DHS-në që të justifikojë vazhdimin e paraburgimit.⁷¹

46. Sa i përket kohëzgjatjes së paraburgimit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se paneli i Gjykatës së Apelit ka konstatuar se paraburgimi i z. Gucati në kohëzgjatje më shumë se dy muaj, edhe në mungesë të aktakuzës së konfirmuar kundër tij, ishte proporcional në këtë fazë të hershme të procesit.⁷² Ndërsa në kohën kur po shkruhet ky vendim z. Gucati është në paraburgim prej tre muajsh, tashmë ekziston aktakuza e konfirmuar kundër tij. Në dritën e këtyre faktorëve, dhe faktit që rreziku i pengimit dhe kryerjes së veprave penale të tjera ende ekziston dhe nuk mund të zbutet me kushte, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se paraburgimi i z. Gucati është i domosdoshëm dhe proporcional në rrethanat aktuale.

E. KËRKESË PËR SEANCË GOJORE

47. Z. Gucati kërkon seancë gojore për të plotësuar parashtrimet e veta me shkrim dhe për t'iu përgjigjur parashtrimeve të ZPS-së.⁷³

48. Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton vendimin e tij të nxjerrë më 18 dhjetor 2002, në të cilin refuzoi kërkesën e z. Gucati për seancë gojore në lidhje me procesin e

⁷¹ Parashtrimi i Mbrojtjes, para. 7-10.

⁷² Vendimi mbi apelin e vendimit të parë për paraburgimin, para. 73.

⁷³ Parashtrimi i Mbrojtjes, para. 31-34.

rishikimit të paraburgimit aktual dymujor.⁷⁴ Z. Gucati nuk ka paraqitur argumente të reja që përlligjin rishqyrtimin e vendimit në fjalë.

49. Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se, ndërsa kërkesa për seancë gojore është refuzuar, kjo nuk e parandalon z. Gucati që të paraqesë kundërshtime të veçanta të paraburgimit ose kërkesa për lirim të përkohshëm, ose me kusht në pajtim me nenin 41(2) dhe (12) të Ligjit dhe rregullat 56(3) dhe 57(2) të Rregullores, në periudhat midis rishikimeve të detyrueshme dymujore të paraburgimit.

50. Së fundi, për të ndihmuar në rishikimin e ardhshëm dymujor të paraburgimit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e urdhëron z. Gucati që t'i paraqesë deri të hënën, 1 shkurt 2021, parashtrime nëse ekzistojnë ende arsye për vazhdimin e paraburgimit të tij. Përgjigjet dhe kundërpërgjigjet ndaj këtyre parashtrimeve dorëzohen në përputhje me afatet e përcaktuara në rregullën 76 të Rregullores.

V. VENDIM

51. Për arsyet e përmendura më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **URDHËRON** vazhdimin e paraburgimit të z. Gucati. dhe
- b. **URDHËRON** z. Gucati që, deri të hënën, 1 shkurt 2021 të paraqesë parashtrime për rishikimin e ardhshëm të paraburgimit.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatësi i Procedurës Paraprake

E enjte, 24 dhjetor 2020

Në Hagë, Holandë

⁷⁴ KSC-BC-2020-07, F00089, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për caktimin e datës së seancës për vetëdeklarim në lidhje me fajësinë ose pafajësinë dhe të konferencës së parë për ecurinë e çështjes dhe çështje të lidhura me to*, 18 dhjetor 2020, publik, para. 3, 16-17.